K.B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 22038 Prot

Lezhë 10. 11 .2026

PROJEKT VENDIM

Nr. — Datë 10 / 11 /2026

"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI VENDOSJEN, SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE MENAXHIMIN E PENGESAVE TË KUFIZIMIT TË SHPEJTËSISË (KURRIZET ARTIFICIALE) NË TERRITORIN E BASHKISË LEZHË"

Në mbështetje Nenit 9, pika 1, shkronja "a" të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë Lezhë:

PROPOZON:

1. Miratimin e Rregullores "Mbi vendosjen, specifikimet teknike dhe menaxhimin e pengesave shtrënguese të shpejtësisë (kurrizet artificiale) në territorin e Bashkisë Lezhë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë..
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 e Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETARI
Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE,INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

Nr.22033/1 Prot, Lezhë, me 10.11.2026

RELACION MBI PROJEKT–VENDIMIN
"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "MBI VENDOSJEN, SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE MENAXHIMIN E PENGESAVE TË KUFIZIMIT TË SHPEJTËSISË (KURRIZET ARTIFICIALE) NË TERRITORIN E BASHKISË LEZHË"

Ky projekt–vendim paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak Lezhë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, bazuar në kërkesat e shumta të paraqitura nga banorët dhe nga vlerësimet teknike të kryera nga strukturat kompetente e Bashkisë Lezhë. Nga verifikimet e kryera në terren është konstatuar se në disa segmente rrugore qarkullimi i mjeteve zhvillohet me shpejtësi të lartë, duke krijuar rrezik potencial për jetën e banorëve. Kjo situatë ka sjellë shqetësime të vazhdueshme në komunitet dhe ka bërë të domosdoshme ndërhyrjen e autoritetit vendor me masa konkrete parandaluese, në funksion të rritjes së sigurisë rrugore. Vendosja e kurrizave artificiale përbën një nga masat më efektive për kufizimin fizik të shpejtësisë së mjeteve, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e rrezikut të aksidenteve dhe në krijimin e kushteve më të sigurta për qarkullimin e këmbësorëve. Kjo ndërhyrje është në përputhje me standardet teknike dhe rregullat e sinjalistikës rrugore, duke garantuar njëkohësisht funksionalitetin e infrastrukturës dhe sigurinë e përdoruesve të saj. Realizimi i këtij projekti pritet të sjellë një sërë përfitimesh për komunitetin, duke përfshirë rritjen e nivelit të sigurisë rrugore, uljen e rasteve të shkeljeve të kufijve të shpejtësisë, minimizimin e rrezikut të aksidenteve, mbrojtjen e jetës të qytetarëve, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës në zonat e banuara. Gjithashtu, kjo masë do të ndikojë pozitivisht në rritjen e ndërgjegjësimit të drejtuesve të mjeteve për respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor. Duke qenë se garantimi i sigurisë së qytetarëve dhe administrimi i infrastrukturës rrugore përbëjnë një nga funksionet themelore të njësisë së vetëqeverisjes vendore, miratimi i këtij projekt-vendimi vlerësohet si një ndërhyrje e nevojshme, e arsyeshme dhe në interes të drejtpërdrejtë publik.

KRYETARI
Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LEZHË

RREGULLORE "MBI VENDOSJEN, SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE MENAXHIMIN E PENGESAVE SHTRËNGUESE TË SHPEJTËSISË (KURRIZET ARTIFICIALE) NË TERRITORIN E BASHKISË LEZHË"

Baza Ligjore

- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë".

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kritereve, standardeve teknike, procedurave administrative dhe përgjegjësive institucionale për projektimin, vendosjen, sinjalizimin, administrimin, monitorimin, mirëmbajtjen dhe heqjen e pengesave shtrënguese të shpejtësisë (kurrizeve artificiale) në rrugët dhe hapësirat publike nën administrimin e Bashkisë Lezhë.

Kjo rregullore rregullon kushtet dhe rastet kur lejohet vendosja e pengesave të shpejtësisë, kriteret teknike që duhet të plotësojnë ato, procedurat e autorizimit, si dhe masat administrative që zbatohen në rastet e ndërhyrjeve të paautorizuara ose në kundërshtim me dispozitat e saj.

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e kritereve, procedurave, standardeve teknike dhe rregullave për vendosjen, administrimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e pengesave shtrënguese të shpejtësisë (kurrizeve artificiale) në rrugët nën administrimin e Bashkisë Lezhë.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj rregulloreje synohet:

a) Rritja e sigurisë rrugore për këmbësorët, çiklistët dhe përdoruesit e tjerë të rrugës;

b) Ulja e shpejtësisë së mjeteve në zonat me risk të lartë aksidentesh, veçanërisht pranë institucioneve arsimore, shëndetësore, zonave të banuara, parqeve dhe hapësirave publike;

c) Garantimi i një qarkullimi të sigurt dhe të rregullt të mjeteve në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore në fuqi;

ç) Unifikimi i standardeve teknike dhe i procedurave administrative për vendosjen e kurrizeve artificiale në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë Lezhë;

d) Parandalimi i vendosjes së pengesave të paautorizuara ose jashtë standardeve teknike, të cilat mund të cenojnë sigurinë rrugore;

dh) Sigurimi i mirëmbajtjes periodike dhe kontrollit të vazhdueshëm të pengesave shtrënguese të shpejtësisë, me qëllim garantimin e efektivitetit dhe sigurisë së tyre.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Kurriz artificial" – element fizik i trafikut rrugor me profil të ngritur, i ndërtuar ose i instaluar mbi sipërfaqen e rrugës, me qëllim uljen e shpejtësisë së mjeteve dhe rritjen e sigurisë rrugore.
2. "Pengesë e shpejtësisë" – çdo pajisje ose strukturë e autorizuar që vendoset në trupin e rrugës për të detyruar drejtuesit e mjeteve të reduktojnë shpejtësinë e lëvizjes.
3. "Sinjalistikë rrugore" – tërësia e shenjave vertikale, horizontale, pajisjeve reflektuese dhe elementëve të tjerë paralajmërues të vendosur sipas legjislacionit rrugor në fuqi.
4. "Parasinjalizim" – vendosja paraprake e sinjalistikës rrugore për të paralajmëruar përdoruesit e rrugës për praninë e një pengese shtrënguese të shpejtësisë.
5. "Rrugë urbane" – rrugë që ndodhet brenda kufijve administrativë të zonave të banuara dhe që shërben për qarkullimin e mjeteve dhe këmbësorëve.
6. "Rrugë nën administrimin e Bashkisë" – çdo rrugë, segment rrugor ose hapësirë publike për të cilën Bashkia Lezhë ushtron kompetencat e administrimit dhe mirëmbajtjes sipas legjislacionit në fuqi.
7. "Zonë me risk të lartë" – zonë ku, për shkak të fluksit të lartë të këmbësorëve, pranisë së institucioneve publike, objekteve arsimore, shëndetësore, sportive apo rekreative, kërkohen masa shtesë për rritjen e sigurisë rrugore.
8. "Pengesë e paautorizuar" – çdo kurriz artificial ose strukturë tjetër e ngjashme e vendosur pa miratimin dhe autorizimin e organit kompetent, ose në kundërshtim me kërkesat e kësaj rregulloreje.

KREU II

KRITERET E LOKACIONIT DHE NDALIMET E SHTRËNGUARA

Neni 4

Zonat ku lejohet vendosja

Kurrizet artificiale mund të vendosen vetëm në:

1. Rrugët e banuara të brendshme të Bashkisë Lezhë ku fluksi i këmbësorëve është i lartë.
2. Parqet publike, zonat rekreative, zonat e vilave apo komplekset private të banimit.
3. Segmente rrugore pranë institucioneve arsimore (shkolla, kopshte, çerdhe), detyrimisht të parasinjalizuara.

Neni 5

Kufizimet

Ndalohet rreptësisht vendosja e kurrizeve artificiale në:

1. Rrugët që përbëjnë itinerare kryesore të përdorura nga mjetet e ndihmës së shpejtë, mjetet zjarrfikëse apo forcat e rendit.
2. Rrugët nacionale ose akset kryesore interurbane që kalojnë përmes territorit të bashkisë ku shpejtësia e projektuar është mbi 50 km/orë.
3. Mbi ura, viadukte, brenda tuneleve ose në kthesa me rreze të vogël ku mund të rrezikohet stabiliteti i mjetit.

Neni 6

Distancat e Ndaluara të Sigurisë

1. Nga kryqëzimet dhe rrethrrotullimet: Nuk lejohet vendosja e asnjë pengese në një distancë më pak se 60 metra nga vija e ndërprerjes së kryqëzimit, daljet e rrugëve dytësore ose hyrjet në rrethrrotullim.
2. Nga kthesat me rreze të ngushtë: Ndalohet vendosja e tyre brenda harkut të kthesës dhe në një distancë prej 70 metrash para fillimit dhe pas përfundimit të kthesës.
3. Distanca midis dy pengesave: Distanca minimale midis tyre nuk duhet të jetë më pak se 200 metra dhe jo më shumë se 400 metra. Ndalohet vendosja e më shumë se dy pengesave në akse me gjatësi nën 500 metra.
4. Pranë urave dhe veprave të artit: Ndalohet vendosja direkt mbi ura, nënkalime, mbikalime ose në një distancë më pak se 50 metra nga hyrje-daljet e këtyre strukturave.
5. Nga vendndalimet e transportit publik: Nuk lejohet vendosja e kurrizeve artificiale në një distancë më pak se 40 metra para dhe pas stacioneve të autobusëve urbanë ose ndërurbanë.

KREU III

SPECIFIKIMET TEKNIKE, FORMAT DHE DIMENSIONET

Neni 7

Karakteristikat Vizuale dhe Dukshmëria

1. Çdo kurriz artificial duhet të jetë maksimalisht i dukshëm si gjatë ditës, ashtu edhe gjatë natës.
2. Sipërfaqja e pengesës duhet të jetë e shenjuar me vija tip zebre, me ngjyra të alternuara të verdha dhe të zeza.
3. Materiali i vijave të verdha duhet të jetë reflektues për ndriçim efektiv gjatë natës.

Neni 8

Dimensionet Gjeometrike sipas Kufirit të Shpejtësisë

1. Pengesat e shpejtësisë duhet të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me kufirin e shpejtësisë së lejuar në segmentin rrugor përkatës.
2. Për rrugët me kufizim shpejtësie deri në 50 km/orë , kurrizi artificial duhet të plotësojë këto parametra:

a) Gjerësia e bazës të jetë jo më pak se 60 cm;
b) Lartësia maksimale të jetë jo më shumë se 3 cm.

3. Për rrugët me kufizim shpejtësie deri në 40 km/orë, kurrizi artificial duhet të plotësojë këto parametra:

a) Gjerësia e bazës të jetë jo më pak se 90 cm;
b) Lartësia maksimale të jetë jo më shumë se 5 cm.

4. Ndalohet përdorimi i pengesave shtrënguese të shpejtësisë me lartësi mbi 5 cm në rrugët urbane dhe në çdo segment rrugor nën administrimin e Bashkisë Lezhë.
5. Materialet, forma dhe përmasat e pengesave duhet të garantojnë sigurinë e qarkullimit rrugor, komoditetin e përdoruesve të rrugës dhe të mos shkaktojnë dëmtime në mjetet që qarkullojnë brenda kufijve të lejuar të shpejtësisë.

KREU IV

PROCEDURA E AUTORIZIMIT DIREKT DHE ZBATIMI

Neni 9

Shqyrtimi

1. Iniciativa për vendosjen e një kurrizi artificial mund të merret nga banorët e komunitetit, administratorët e njësive ose nga nevojat e vetë bashkisë.
2. Çdo kërkesë shqyrtohet dhe autorizohet drejtpërdrejt nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit.
3. Nëse gjatë verifikimit rezulton se në aks ekziston një pengesë tjetër ose pikë kritike brenda distancave të Nenit 5, kërkesa refuzohet automatikisht.
4. Drejtoria nxjerr urdhër-ekzekutimi brenda 15 ditëve nga miratimi i kërkesës.

Neni 10

Sinjalistika e Detyrueshme Shoqëruese

Asnjë kurriz artificial nuk mund të instalohet pa:

- Tabelën paralajmëruese "Kurriz në Rrugë" të vendosur 150 metra përpara pengesës;
- Tabelën e kufizimit të shpejtësisë;
- Vijëzimin horizontal mbi vetë pengesën.

KREU V

SANKSIONET DHE MIRËMBAJTJA

Neni 11

Pengesat e Paligjshme dhe Masat Ndëshkimore

1. Çdo person fizik ose juridik që ndërton kurrize artificiale pa autorizim ndëshkohet me gjobë nga Policia Bashkiake dhe IMT Lezhë.
2. Shkelësi detyrohet të përballojë kostot e rikthimit të rrugës në gjendjen e mëparshme.

Neni 12

Inspektimi dhe Mirëmbajtja

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit detyrohet të kryejë inspektime për kontrollin e gjendjes së pengesave, stabilitetit të elementeve fiksues dhe dukshmërisë së sinjalistikës reflektuese, duke kryer menjëherë ndërhyrjet e nevojshme për garantimin e sigurisë rrugore.

KRYETARI
Pjerin NDREU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË